



USHTRIA



Viti i 79-të i botimit Nr. 13 (827969)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 3 prill 2026



SHQIPËRIA, 17 VITE NË NATO NJË RRUGËTIM SUKSESI, SIGURIE DHE DINJITETI KOMBËTAR

» faqe 3



STËRVITJE E PËRBASHKËT NË KUADËR TË "NEPTUNE STRIKE 26-1"

Forca Detare dhe Forcat Speciale shqiptare rrisin ndërveprueshmërinë me homologët italianë në operacionet detare. Efektivat e Forcës Detare dhe Forcave Speciale të Forcave të Armatosura shqiptare zhvilluan një stërvitje të përbashkët me homologët e tyre italianë, në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare "Neptune Strike 26-1". Kjo stërvitje u fokusua në realizimin e skenarëve operacionale kompleksë në mjedisin detar, me qëllim testimin dhe demonstrimin e aftësive operacionale të trupave pjesëmarrëse, si dhe rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat aleate...

faqe 2



"SKËNDERBEGASIT NDËR VITE..." MEMORIA QË NUK SHUHET

Në një atmosferë të rrallë emocionesh, kujtimesh dhe krenarie kombëtare, më 28 mars 2026, mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes u mbushën plot për promovimin e volumit të pestë të kolanës "Skënderbegasit ndër vite...", një vepër që tashmë ka marrë përmasat e një arkivi të gjallë të historisë së ushtrisë shqiptare. Ky aktivitet nuk ishte thjesht një promovim libri. Ai ishte një rikthim në kohë, një bashkim brezash dhe një dëshmi e gjallë se kujtesa historike, kur dokumentohet me përkushtim, shndërrohet në pasuri kombëtare...

faqe 10



"ÇDO JETË KA VLERË", NË NJË BOTË QË MËSON TË DËGJOJË: AUTIZMI MES DHIMBJES, FORCËS DHE SHPRESËS

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më 2 prill, dritat blu që ndriçojnë qytetet në mbarë botën nuk janë thjesht një simbol. Ato janë një thirrje. Një kujtesë. Një reflektim kolektiv mbi një realitet që për shumë familje nuk zgjat vetëm një ditë, por çdo sekondë të jetës së tyre. Dita Botërore e Ndërgjegjësisë për Autizmin...

faqe 9

FORCOHET BASHKËPUNIMI USHTARAK ME JORDANINË DHE PAKISTANIN

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm zhvilloi takime me atashe ushtarake për rritjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimin e eksperiencave

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletenant Arben Kingji, zhvilloi dy takime të rëndësishme me përfaqësues ushtarake të vendeve partnere.

Gjatë një takimi zyrtar, gjeneralletenant Kingji pati kënaqësinë të priste atasheun ushtarak të Mbretërisë së Jordanisë, gjeneral brigade R'ad Abdelhameed Doura. Në fokus të bisedës ishte identifikimi i mundësive konkrete për zgjerimin e bashkëpunimit ushtarak mes dy vendeve.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm shprehu mirënjohjen për kontributin e Jordanisë në ruajtjen e paqes dhe në përbashkëtimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë, duke e vlerësuar atë si një partner të rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit me NATO-n.

Në një tjetër takim, gjeneralletenant Arben Kingji priti atasheun ushtarak të Republikës së Pakistanit, gjeneral brigade Imtiaz Shahzada. Gjatë këtij takimi, palët diskutuan mbi rritjen e bashkëpunimit dypalësh, me theks të veçantë në shkëmbimin e eksperiencave dhe zhvillimin e trajnimeve të përbashkëta.

Të dyja takimet u zhvilluan në një frymë miqësore dhe konstruktive, duke reflektuar vullnetin e përbashkët për



forcimin e marrëdhënieve ushtarake dhe përbashkëtimin e sfidave të sigurisë në nivel rajonal dhe global.

Këto angazhime konfirmojnë rolin aktiv të Forcave të

Armatosura shqiptare në ndërtimin e partneriteteve të qëndrueshme dhe në rritjen e kapaciteteve profesionale nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar.



STËRVITJE E PËRBASHKËT NË KUADËR TË “NEPTUNE STRIKE 26-1”

Forca Detare dhe Forcat Speciale shqiptare rrisin ndërveprueshmërinë me homologët italianë në operacionet detare

Efektivat e Forcës Detare dhe Forcave Speciale të Forcave të Armatosura shqiptare zhvilluan një stërvitje të përbashkët me homologët e tyre italianë, në kuadër të stërvitjes ndërkombëtare “Neptune Strike 26-1”.

Kjo stërvitje u fokusua në realizimin e skenarëve operacionalë kompleksë në mjedisin detar, me qëllim testimin dhe demonstrimin e aftësive operacionale të trupave pjesëmarrëse, si dhe rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat aleate.

Gjatë zhvillimit të saj, efektivat shqiptarë dhe italianë bashkëpunuan ngushtë në operacione të ndryshme taktike, duke shkëmbyer përvojë dhe praktika më të mira në fushën e operacioneve detare dhe speciale.

Pjesëmarrja në “Neptune Strike 26-1” përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e kapaciteteve profesionale të Forcave të Armatosura shqiptare dhe në forcimin e bashkëpunimit me vendet aleate, veçanërisht me Italinë, një partner strategjik në fushën e mbrojtjes.



Kjo stërvitje dëshmon angazhimin e vazhdueshëm të Shqipërisë për të kontribuar në operacionet e përbashkëta dhe për të përmbushur standardet e NATO-s në garantimin e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë.



STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni “Skënderbej”

SHQIPËRIA, 17 VITE NË NATO NJË RRUGËTIM SUKSESI, SIGURIE DHE DINJITETI KOMBËTAR

Më 1 prill 2009, Shqipëria shënoi një nga momentet më të rëndësishme të historisë së saj moderne: anëtarësimin në NATO. Sot, pas 17 vitesh në këtë aleancë të fuqishme ushtarake dhe politike, vendi ynë feston me krenari një rrugëtim të mbushur me sfida, përkushtim dhe arritje.

Në Garnizonin e Forcës Tokësore, në Zall Herr, Forcat e Armatosura të Shqipërisë organizuan një ceremoni solemne për të përkujtuar këtë datë historike. Të pranishëm në aktivitet ishin drejtues të lartë të institucioneve të mbrojtjes, përfaqësues politikë dhe ushtarakë të të gjitha niveleve.

Atmosfera e ceremonisë ishte një ndërthurje e solemnitetit dhe krenarisë kombëtare, ku çdo detaj reflektonte rrugën e gjatë të Shqipërisë drejt integritetit euro-atlantik.

Vlerësimi i arritjeve dhe roli i Forcave të Armatosura

Ministri i Mbrojtjes, z. Ermal Nufi, në fjalën e tij përshëndetëse, vlerësoi progresin e bërë gjatë këtyre 17 viteve: **“Shqipëria duhet të ndihet krenare për gjithçka kemi ndërtuar në këto 17 vite. Krenarë për besimin që kemi fituar dhe për profesionalizmin e grave dhe burrave në uniformë, që përfaqësojnë Shqipërinë me dinjitet në çdo mision”.**

Ministri Nufi theksoi se Shqipëria sot është një faktor stabiliteti në rajon dhe një aleat i besueshëm në krah të NATO-s, duke ndjekur të njëjtin ritëm zhvillimi dhe modernizimi.

Ndërkohë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, nënvizoi rëndësinë historike të këtij anëtarësimi dhe rolin aktiv të Shqipërisë: **“Që nga ky moment historik, Shqipëria ka dëshmuar përkushtim të palëkundur ndaj vlerave të Aleancës, duke u shndërruar në një kontribuuese aktive në misionet dhe operacionet e përbashkëta.”**

Ai shprehu mirënjohje për aleatët ndërkombëtarë për mbështetjen në rritjen e kapaciteteve operacionale të vendit.

Modernizimi dhe kontributi ndërkombëtar

Gjatë këtyre 17 viteve, Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë kaluar një transformim të thellë: rritje të kapaciteteve operacionale; pjesëmarrje aktive në misione paqeruajtëse ndërkombëtare; përshtatje me standardet e NATO-s dhe modernizim të pajisjeve dhe trajnimeve.

Në kuadër të ceremonisë, të pranishmit patën mundësinë të shohin nga afër mjetet dhe pajisjet ushtarake të ekspozuara, si dhe të njihen me nivelin e gatishmërisë së forcave tona.



Ky përvjetor shërbeu edhe si një moment reflektimi mbi rrugën e bërë dhe sfidat e së ardhmes, në një botë ku siguria mbetet një prioritet thelbësor.

Një festë dinjitoze dhe mesazh për të ardhmen

Aktivitetet për këtë ditë kulmuan me një koncert madhështor në skenën e Akademisë së Arteve, organizuar me kujdesin e veçantë të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Interpretimet artistike nga Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura (OFFA), në bashkëpunim me Qendrën e Kulturës, sollën një atmosferë festive dhe emocionuese, duke ndërthurur artin me ndjenjën e patriotizmit.

Kjo ditë nuk ishte vetëm një përkujtim historik, por edhe një rikonfirmim i angazhimit të Shqipërisë për të vijuar kontributin aktiv në NATO.

Pas 17 vitesh në Aleancë, Shqipëria vazhdon të qëndrojë e palëkundur në misionin e saj për paqe, siguri dhe bashkëpunim ndërkombëtar, një vend që ecën përpara, gjithmonë krah aleatëve të saj.

17-ujtori i anëtarësimit në NATO është më shumë se një datë, është një dëshmi e përkushtimit të Shqipërisë ndaj vlerave demokratike, sigurisë kolektive dhe të ardhmes euro-atlantike. Një histori sukcesi që vazhdon të shkruhet çdo ditë nga burrat dhe gratë në uniformë.





SHQIPËRIA DHE RUMANIA THELLOJNË PARTNERITETIN USHTARAK DHE ANGAZHIMIN NË KUADËR TË NATO-S

Bukuresht, Rumani – Në kuadër të një vizite zyrtare në Rumani, u zhvillua një takim i rëndësishëm me Shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Rumune, gjeneral Gheorghita Vlad, ku në qendër të diskutimeve ishte forcimi i marrëdhënieve dypalëshe dhe zgjerimi i bashkëpunimit ushtarak ndërmjet dy vendeve.

Gjatë takimit, u vlerësuan marrëdhëniet e qëndrueshme Shqipëri-Rumani dhe u theksua vullneti i përbashkët për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit, veçanërisht në drejtim të zhvillimit të stërvitjeve të përbashkëta, edukimit ushtarak dhe shkëmbimit të eksperiencave profesionale ndërmjet forcave të armatosura.

Palët riafirmuan se objektivi i përbashkët mbetet rritja e gatishmërisë, ndërveprueshmërisë dhe efikasitetit në përmbushjen e detyrimeve, si në kuadër bilateral, ashtu edhe në atë rajonal dhe në kuadrin e Aleancës së NATO-s, ku të dy vendet janë anëtare aktive.

Gjatë vizitës u shpreh mirënjohje për rolin dhe kontributin e Rumanisë në ruajtjen e sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë, duke theksuar njëkohësisht angazhimin e palëkundur të Shqipërisë për një rajon më të sigurt dhe më të qëndrueshëm.

Në vijim të axhendës, u zhvillua një vizitë në Komandën e Korpusit Shumëkombësh Jug-Lindje (HQ MNC-SE), ku u njoh nga afër roli dhe kontributi i kësaj strukture në forcimin e krahut lindor të NATO-s, si një shembull konkret i bashkëpunimit shumëkombësh dhe mbrojtjes kolektive.

Gjithashtu, u zhvilluan takime me shefin e Shtabit të Korpusit, gjeneralmajor Costantin Nicolaescu, si dhe me komandantin e Grup-Batalionit të Forcave të Përparuara Tokësore, kolonel Florian De La Tousche, ku u diskutuan çështje të rëndësishme të bashkëpunimit operacional dhe zhvillimit të kapaciteteve ushtarake.

Vizita u përmbyll me shprehjen e falënderimeve për mikpritjen e veçantë nga pala rumune dhe me theksimin e angazhimit të përbashkët për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak, në funksion të paqes, sigurisë dhe stabilitetit në rajon dhe më gjerë.



MBLIDHET KOMITETI I KËRKIM-SHPËTIMIT: THEKS, RITJJA E KOORDINIMIT NDËRINSTITUCIONAL

U zhvillua takimi i radhës i Komitetit të Kërkim-Shpëtimit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve anëtare, ku në fokus të diskutimeve ishin prioritetet kryesore të punës së përbashkët për përmirësimin e kapaciteteve kombëtare në këtë fushë.

Gjatë mbledhjes, u theksua rëndësia e forcimit të koordinimit ndërinstitucional, si një element kyç për rritjen e efektivitetit të operacioneve të kërkim-shpëtimit në nivel

kombëtar. Pjesëmarrësit ndanë vlerësime dhe propozime konkrete për përmirësimin e bashkëpunimit, shkëmbimin e informacionit dhe reagimin e shpejtë në situata emergjente.

Në këtë kuadër, u diskutuan edhe mekanizmat për rritjen e ndërveprueshmërisë mes strukturave përgjegjëse, si dhe nevoja për trajnime të përbashkëta dhe përditësim të procedurave operative standarde.

Takimi shërbeu si një platformë e rëndësishme për harmonizimin e përpjekjeve ndërinstitucionale, duke synuar rritjen e gatishmërisë dhe përmirësimin e reagimit në mbrojtje të jetës dhe pronës së qytetarëve.

Komiteti i Kërkim-Shpëtimit mbetet një strukturë kyçe në garantimin e një përgjigjeje të koordinuar dhe efikase ndaj emergjencave, duke reflektuar angazhimin e institucioneve për të rritur sigurinë dhe mbrojtjen civile në vend.



KTHOSH përmbyll me sukses vizitën studimore në strukturat kryesore të Forcave të Armatosura

Koleji i Mbrojtjes dhe Sigurisë përmbylli me sukses programin e vizitës studimore për Kursin Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH), zhvilluar në periudhën 24-27 mars 2026. Ky aktivitet, pjesë thelbësore e formimit akademik dhe operacional të kursantëve, kishte për qëllim njohjen nga afër me kapacitetet mbrojtëse, infrastrukturën kritike dhe funksionimin në terren të Forcave të Armatosura të Shqipërisë.

Programi nisi në Bazën Ajrore të Farkës, prej nga kursantët realizuan një fluturim me helikopter të tipit "Cougar" drejt Bazës Ajrore të Kuçovës. Gjatë kësaj vizite, ata u njohën me historikun e bazës, modernizimin e saj sipas standardeve të NATO-s, si dhe me kapacitetet ajrore bashkëkohore, përfshirë integrimin e mjeteve fluturuese pa pilot.

Më tej, vizita vijoi në Regjimentin e Jugut në Poshnje, ku kursantët u informuan mbi strukturën organizative, misionin dhe detyrat operacionale që ky repart përmbush në funksion të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare.

Në ditën e dytë, programi u përqendrua në komponentin detar. Përmes një lundrimi studimor në Gjirin e Vlorës, përgjatë gadishullit të Karaburunit dhe ishullit të Sazanit, kursantët u njohën me detyrat e Forcës Detare dhe Rojës Bregdetare, përfshirë monitorimin e hapësirës detare, operacionet e kërkim-shpëtimit (SAR) dhe sfidat e sigurisë në mjedisin detar.

Aktivitetet vijuan në Distriktin Detar Jugor në Pashaliman, ku kursantët u pritën nga komandanti i këtij distrikti, kapiten i rangut të parë Dritan Seraj. Gjatë kësaj vizite u prezantuan kapacitetet operacionale, modernizimi i flotës dhe rritja e gatishmërisë luftarake. Kursantët patën gjithashtu mundësinë të shohin nga afër anijet e flotiljes detare dhe Qendrën e Zhytjes.

Në kuadër të vizitës, trupa pedagogjike zhvilloi një takim edhe me komandantin e Forcës Detare, kundëradmiral Arsen Mullaj, ku u theksua rëndësia e ndërthurjes së përgatitjes teorike me eksperiencën praktike në terren, në funksion të



përmbushjes së detyrimeve kombëtare dhe angazhimeve në kuadër të NATO-s.

Programi u përmbyll me një vizitë në Parkun Arkeologjik të Orikut, duke kombinuar edukimin ushtarak me njohjen e trashëgimisë historike dhe kulturore të vendit.



Ky cikël vizitash përfaqëson një hallkë të rëndësishme në përgatitjen profesionale të oficerëve të rinj, duke shërbyer si urë lidhëse mes teorisë akademike dhe realitetit operacional, si dhe duke i përgatitur ata për të kontribuar me profesionalizëm në strukturat kombëtare dhe ato shumëkombëshe.



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA, PJESË E PANAIRIT "WORK & STUDY" NË PRISHTINË

Prishtinë – Akademia e Forcave të Armatosura mori pjesë për herë të parë në panairin "Work & Study", duke sjellë më pranë të rinjve mundësitë e studimit dhe zhvillimit profesional në radhët e Forcave të Armatosura.

Gjatë këtij aktiviteti, një numër i madh maturantësh dhe studentësh vizituan stendën e Akademisë, ku u njohën nga afër me programet e studimit, përfitimet që ofron arsimit ushtarak, si dhe perspektivat e një karriere në shërbim të vendit.

Përfaqësuesit e Akademisë prezantuan ofertën akademike dhe trajnuese, duke theksuar rëndësinë e përgatitjes profesionale, disiplinës dhe zhvillimit të aftësive udhëheqëse që ofron arsimit ushtarak.



Pjesëmarrja në panairin "Work & Study" në Prishtinë u vlerësua si një mundësi e shkëlqyer për të forcuar lidhjet me të rinjtë shqiptarë në Kosovë, si dhe për të promovuar arsimin cilësor dhe rolin e Forcave të Armatosura në ndërtimin e së ardhmes.

Ky angazhim dëshmon përkushtimin e Akademisë së Forcave të Armatosura për të afruar të rinjtë drejt një rruge profesionale me vlera, përgjegjësi dhe kontribut në sigurinë dhe zhvillimin e vendit.



BATALIONI I XHENIOS NDËRTON URË METALIKE NË LIBRAZHD, NË MBËSHTETJE TË KOMUNITETIT

Librazhd – Specialistë të Kompanisë së Urave në Batalionin e Xhenios vijnë punën në terren për ndërtimin e një ure metalike në bashkinë Librazhd, në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe lehtësimit të jetës së banorëve.

Bëhet fjalë për ndërtimin e një ure metalike tip "Bailey", me gjatësi 30 metra dhe seksion 2/1, e cila pritet t'u shërbejë rreth 3000 banorëve të zonës. Kjo ndërhyrje do të mundësojë lëvizje më të sigurt dhe më të shpejtë, si dhe do të lehtësojë kryerjen e aktiviteteve të përditshme për banorët e fshatrave të njësive administrative Orenjë dhe Lunik.

Ndërtimi i kësaj ure përfaqëson një investim të rëndësishëm në shërbim të komunitetit lokal, duke përmirësuar ndjeshëm aksesin dhe lidhjen ndërmjet zonave të ndryshme.

Batalioni i Xhenios vijon të mbetet i angazhuar në mbështetje të komunitetit, përmes realizimit të projekteve infrastrukturore që kontribuojnë drejtpërdrejt në rritjen e mirëqenies dhe sigurisë së qytetarëve.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Ka histori që nuk lexohen... përjetohen.

Ka dhimbje që nuk tregohen... ndihen në heshtje. Dhe ka tragjedi që nuk janë thjesht të një individi, por janë aktakuzë për një shoqëri të tërë.

Historia e **Noelia Castillo** është një nga ato histori që nuk duhet thjesht të na prekë, duhet të na tronditë, të na shqetësojë, të na detyrojë të shohim veten në pasqyrë dhe të pranojmë një të vërtetë të hidhur: **Ne kemi dështuar.**

Jo vetëm si individë.

Por si shoqëri.

Si njerëzim.

Një histori që nuk duhet harruar

Një vajzë e re. Një jetë e shkatërruar nga dhuna. Një shoqëri që në vend ta mbrojë, e gjykon. Dhe një fund që ngre më shumë pyetje sesa përgjigje.

Historia e **Noelia Castillo** nuk është thjesht një lajm. Nuk është thjesht një ngjarje tragjike që kalon në rrjedhën e përditshme të informacionit.

Është një alarm. Një thirrje që godet ndërgjegjen tonë kolektive dhe na detyron të pyesim:

Ku kemi gabuar si shoqëri?

Sepse kjo histori nuk fillon me fundin. Ajo fillon me dhunën. Vazhdon me heshtjen. Dhe përfundon me një dëshpërim të thellë.

Përdhunimi: Plagë që nuk shihet, por nuk shërohet kurrë plotësisht

Përdhunimi është një nga krimet më të rënda që ekzistojnë. Por shpesh, ajo që nuk kuptohet është se dëmi i tij nuk është vetëm fizik.

Ai është: shkatërrim i identitetit, humbje e besimit tek njerëzit, frikë e përhershme, traumë që rikthehet çdo ditë.

Një viktimë nuk e "kalon" thjesht këtë përvojë. Ajo jeton me të. Dhe kur kësaj traume i shtohet gjykimi i shoqërisë, dhimbja shumëfishohet. Kjo është dhuna e dytë. Një dhunë pa duar, por me pasojat të thella.

Kur viktima bëhet e akuzuara

Në vend që të mbështetet, viktima shpesh përballet me pyetje si: "Pse ishte aty?", "Çfarë kishte veshur?", "A është e sigurt që është e vërtetë?"

Këto nuk janë pyetje të pafajshme. Janë forma të maskuara të fajësimit.

Shoqëria, në shumë raste, nuk është një vend i sigurt për viktimat. Është një gjykatë pa drejtësi. Dhe ky realitet është i frikshëm. Sepse i dërgon një mesazh të qartë çdo viktime tjetër: **"Mos fol!"**.

Kur jeta bëhet barrë

Pas një tentative të dështuar për vetëvrasje, pasojat fizike mund të jenë të rënda.

Por ajo që shpesh harrohet është se dhimbja më e madhe nuk është gjithmonë ajo e trupit.

Është ajo e shpirtit.

MOS E GJYKONI DHIMBJEN QË NUK E KENI JETUAR

Kur një shoqëri dështon: Historia që duhet të na turpërojë të gjithëve



KJO HISTORI NUK DUHET TË NA
LËRË INDIFERENTË.

AJO DUHET TË NA NDRYSHOJË.

SEPSE ÇDO HERË QË: GJYKOJMË

NJË VIKTIMË, HESHTIM PËRBALLË

PADREJTËSISË, MINIMIZOJMË

DHUNËN.

NE BËHEMI PJESË E PROBLEMIT.

ËSHTË KOHA PËR TË REFLEKTUAR.

ËSHTË KOHA PËR TË VEPRUAR.

SEPSE NJË SHOQËRI QË NUK

MBRON MË TË DOBËTIT, KA

HUMBUR HUMANIZMIN E SAJ.

Të jetosh me: traumë të pandërprerë, dhimbje fizike, mungesë shprese, ndjenjë braktisjeje, është një betejë e përditshme.

Dhe jo të gjithë arrijnë ta përballojnë.

EUTANAZIA DHE DEBATI MORAL

Mes ligjit dhe ndërgjegjes

Në disa vende, eutanazia konsiderohet si një e drejtë.

Por kjo çështje mbetet thellësisht e ndërlikuar.

Nga njëra anë: dhembshuria për vuajtjen dhe dëshira për paqe.

Nga ana tjetër: shenjtëria e jetës, besimi se jeta nuk duhet ndërprerë nga njeriu.

Kjo nuk është një çështje e thjeshtë. Nuk ka përgjigje të lehta. Por një gjë është e sigurt: **Asnjë ligj nuk mund të zëvendësojë mungesën e dashurisë dhe mbështetjes.**

Një thirrje për ndryshim

Kjo histori nuk duhet të na lërë indiferentë.

Ajo duhet të na ndryshojë.

Sepse çdo herë që: gjykojmë një viktimë, heshtim përballë padrejtësisë, minimizojmë dhunën.

Ne bëhemi pjesë e problemit. Është koha për të reflektuar. Është koha për të vepruar.

Sepse një shoqëri që nuk mbron më të dobët, ka humbur humanizmin e saj.

Ajo luftoi me dhimbjen... ne e mbytëm me heshtje

Mos e lexoni këtë si një histori të largët.

Shiheni si një realitet që mund të ndodhë kudo.

Dhe pyesni veten: **Në cilën anë do të jeni?**

Në anën e gjykimit... apo në anën e njerëzimit?

Ndaloni dhunën!

Ndaloni gjykimin!

Mbroni dinjitetin njerëzor!



Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut, NATO, mbetet një nga aleancat më të rëndësishme ushtarake dhe politike në historinë moderne. E themeluar në vitin 1949 në kulmin e tensioneve mes Perëndimit dhe Bashkimi Sovjetik, ajo u krijua si një përgjigje strategjike ndaj kërcënimit të përhapjes së komunizmit në Europë. Sot, më shumë se shtatë dekada më vonë, NATO jo vetëm që ka mbijetuar, por është transformuar në një aktor kyç të sigurisë globale, duke reflektuar ndryshimet e thella gjeopolitike të kohës.

Fillimet: Një aleancë për mbrojtje kolektive

Në prill të vitit 1949, Shtetet e Bashkuara, Kanadaja dhe dhjetë vende europiane nënshkruan Traktatin e Uashingtonit, duke hedhur themelet e NATO-s. Në zemër të kësaj marrëveshjeje qëndronte Neni 5, parimi i mbrojtjes kolektive, i cili përcaktonte se një sulm ndaj një vendi anëtar do të konsiderohej si një sulm ndaj të gjithë aleancës.

Ky nen u bë shtylla kryesore e stabilitetit dhe një faktor i rëndësishëm në frenimin e përshkallëzimit të konfliktit gjatë Luftës së Ftohtë.

Hyrja e Gjermanisë Perëndimore në NATO në vitin 1955 ishte një moment kyç që rriti tensionet me Lindjen. Si reagim, Bashkimi Sovjetik krijoi Traktatin e Varshavës, një aleancë ushtarake që përfshinte vendet e Europës Lindore, përfshirë Shqipërinë. Ky zhvillim institucionalizoi ndarjen e botës në dy blloqe rivale dhe thelloi përplasjen ideologjike dhe ushtarake mes tyre.

Transformimi pas Luftës së Ftohtë

Rënia e Bashkimit Sovjetik në vitin 1991 dhe përfundimi i Luftës së Ftohtë shënuan një pikë kthese për NATO-n. Aleanca u përball me një pyetje ekzistenciale: cili do të ishte roli i saj në një botë pa armikun e saj tradicional?

Përgjigjja erdhi përmes transformimit. NATO u rikonceptua si një organizatë që promovon bashkëpunimin dhe sigurinë ndërkombëtare. Ajo nisi dialog me ish-vendet e Traktatit të Varshavës dhe ndërmori operacione paqeruajtëse dhe stabilizuese në zona konflikti, veçanërisht në Ballkan. Ndërhyrjet në rajon, përfshirë Kosovën, dëshmuuan se NATO nuk ishte më vetëm një aleancë mbrojtëse, por edhe një aktor aktiv në menaxhimin e krizave.

Zgjerimi drejt Lindjes dhe tensionet me Rusinë

Një nga aspektet më të debatueshme të NATO-s në epokën post-komuniste ka qenë zgjerimi i saj drejt Lindjes. Në vitin 1999, Polonia, Hungaria dhe Republika Çeke u bënë anëtare të reja. Pesë vite më vonë, në vitin 2004, shtatë vende të tjera, përfshirë shtetet baltike dhe disa vende të Europës Juglindore, iu bashkuan aleancës.

Nga shumë vende të Europës Lindore ky zgjerim u pa si garanci sigurie dhe integrimi në Perëndim.

Shqipëria dhe integrimi në NATO

Një moment historik për Shqipërinë ishte ftesa për anëtarësim në NATO në vitin 2008, së bashku me Kroacinë. Në vitin 2009, Shqipëria u bë zyrtarisht pjesë e aleancës, duke realizuar një objektiv strategjik të rëndësishëm kombëtar. Ky anëtarësim përforcoi pozitën ndërkombëtare të vendit dhe kontribuoi në stabilitetin rajonal.

NATO: Nga një aleancë kundër Luftës së Ftohtë në garantuesin kryesor të sigurisë globale



Një epokë e re pas vitit 2022

Ngjarjet e 24 shkurtit 2022, kur presidenti Vladimir Putin urdhëroi pushtimin e Ukrainës, shënuan një kthesë dramatike në arkitekturën e sigurisë europiane. Ky zhvillim riktheu frikën e një konflikti të gjerë në kontinent dhe i dha NATO-s një rol edhe më të rëndësishëm.

Në këtë kontekst, vende tradicionalisht neutrale si Finlanda dhe Suedia aplikuan për anëtarësim në NATO. Vendimi i tyre shënon një ndryshim historik dhe pasqyron një transformim të opinionit publik në këto vende, të nxitur nga agresioni rus.

Forcimi i mbrojtjes dhe unitetit

Përballë këtij realiteti të ri, vendet anëtare të NATO-s kanë rritur ndjeshëm angazhimin e tyre për mbrojtjen kolektive. Aleanca ka vendosur të rrisë numrin e trupave në gatishmëri

të lartë në mbi 300 mijë, duke u fokusuar veçanërisht në krahun lindor.

Mesazhi për Moskën është i qartë: NATO mbetet e bashkuar dhe e vendosur për të mbrojtur çdo centimetër të territorit të saj. Ky unitet është një nga pikat më të forta të aleancës dhe një faktor kyç në ruajtjen e paqes dhe stabilitetit.

Një aleancë që përshtatet me kohën

Nga një aleancë e krijuar për të përballuar kërcënimin sovjetik, NATO është shndërruar në një organizatë dinamike që i përgjigjet sfidave të reja globale. Në një botë gjithnjë e më të pasigurt, roli i saj mbetet thelbësor.

Ndërsa tensionet gjeopolitike vazhdojnë dhe sfidat e sigurisë evoluojnë, NATO duket e vendosur të ruajë misionin e saj themelor: mbrojtjen e paqes, stabilitetit dhe vlerave demokratike në një botë në ndryshim të vazhdueshëm.

"QIELLI ISHTE SFIDA E TYRE"

Katër parashutistet e para shqiptare – Flora Toto, Drane Cara, Poliskeni Gorishti, Vezire Meta dhe fluturimi historik i vitit 1968

NJË HAP I GUXIMSHËM NË HISTORINË E USHTRISË

Në historinë e Forcave të Armatosura shqiptare ka momente që shënojnë kthesa të rëndësishme, jo vetëm në aspektin ushtarak, por edhe në atë shoqëror. Një ndër këto momente është padyshim viti 1968, kur për herë të parë katër vajza shqiptare guxuan të sfidonin qiellin dhe paragjykimet e kohës, duke u bërë parashutistet e para të vendit.

Flora Toto, Drane Cara, Poliskeni Gorishti dhe Vezire Meta nuk ishin thjesht pjesë e një eksperimenti ushtarak. Ato u kthyen në simbol të një epoke që po kërkonte të ndryshonte rolin e gruas në shoqëri dhe në ushtri.

Në një kohë kur profesioni ushtarak, e aq më tepër ai i parashutistit, konsiderohej i papërshtatshëm për gratë, këto katër vajza treguan se guximi, përkushtimi dhe disiplina nuk kanë gjini.

Hedhja e tyre e parë me parashutë në vitin 1968 ishte më shumë se një akt teknik, ishte një deklaratë e fortë, gruaja shqiptare mund të jetë aty ku është sfida më e madhe.

RRUGA DREJT QIELLIT

Për t'u bërë pjesë e këtij misioni të veçantë, kërkohesh shumë më tepër sesa dëshirë. Përzgjedhja ishte rigoroze dhe përfshinte përgatitje fizike intensive, testime psikologjike dhe një disiplinë të hekurt ushtarake.

Flora Toto, Drane Cara, Poliskeni Gorishti dhe Vezire Meta kaluan një proces të gjatë përgatitor. Ato u trajnuan në kushte të vështira, duke përballuar lodhjen fizike dhe presionin psikologjik që sjell ideja e hedhjes nga ajri.

Instruktorët e kohës kujtojnë se këto vajza shquheshin për vendosmërinë e jashtëzakonshme, disiplinën e lartë, përkushtimin maksimal ndaj detyrës.

Ato nuk kërkuan trajtim të veçantë. Përkundrazi, kërkuan të trajtoheshin si çdo ushtarak tjetër dhe kështu ndodhi.

HEDHJA QË HYRI NË HISTORI

Momenti i hedhjes ishte kulmi i një përgatitjeje të gjatë. Viti 1968 do të mbetej i paharrueshëm për ushtrinë shqiptare, sepse për herë të parë, katër gra do të hidhnin parashutën nga qielli shqiptar.

Në ato çaste, nuk ishte vetëm lartësia që duhej përballuar. Ishte frika, përgjegjësia dhe pesha e një momenti historik. Kur dera e avionit u hap dhe qielli u shfaq përpara tyre, ato nuk u tërhoqën.

Njëra pas tjetrës, Flora Toto, Drane Cara, Poliskeni Gorishti dhe Vezire Meta u hodhën, duke realizuar me sukses një nga aktet më të guximshme të kohës.

Parashutat u hapën mbi tokën shqiptare, duke simbolizuar jo vetëm një sukses teknik, por një fitore morale dhe shoqërore.

TRASHËGIMIA E TYRE

Kontributi i këtyre katër grave nuk përfundoi me atë hedhje historike. Ato u kthyen në modele për brezat e ardhshëm të vajzave dhe grave që synonin të bëheshin pjesë e Forcave të Armatosura.

Trashëgimia e tyre është e shumëfishtë: thyen stereotipat



1968



për rolin e gruas në ushtri, hapën rrugën për pjesëmarrjen femërore në specialitete të vështira dhe dëshmuar se guximi nuk njih kufij.

Sot, kur gratë shqiptare janë pjesë aktive e ushtrisë në role të ndryshme, duhet kujtuar se ky rrugëtim nisi edhe falë guximit të këtyre katër parashutisteve.

Ato nuk kërkuan lavdi. Por historia ua dha.

Flora Toto, Drane Cara, Poliskeni Gorishti dhe Vezire Meta mbeten emra që duhen përmendur me respekt në historinë e ushtrisë shqiptare.

Ato nuk sfiduan vetëm gravitetin. Ato sfiduan kohën, mentalitetin dhe kufijtë që shoqëria vendoste për gratë.

Dhe në atë qiell të vitit 1968, ato nuk u hodhën thjesht me parashutë ato u hodhën drejt historisë.



"ÇDO JETË KA VLERË", në një botë që mëson të dëgjojë: Autizmi mes dhimbjes, forcës dhe shpresës

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Më 2 prill, dritat blu që ndriçojnë qytetet në mbarë botën nuk janë thjesht një simbol. Ato janë një thirrje. Një kujtesë. Një reflektim kolektiv mbi një realitet që për shumë familje nuk zgjat vetëm një ditë, por çdo sekondë të jetës së tyre. Dita Botërore e Ndërgjegjësimit për Autizmin, e shpallur nga Organizata e Kombeve të Bashkuara në vitin 2007, sot ka marrë një dimension shumë më të thellë: nuk është më vetëm ndërgjegjësim, por një kërkesë e fortë për dinjitet, pranim dhe drejtësi.

Pas statistikave dhe termave shkencorë fshihen histori reale. Fëmijë që luftojnë të kuptohen. Prindër që përballen me një sistem që shpesh nuk i mbështet. Të rinj që kërkojnë vendin e tyre në një botë që ende nuk është ndërtuar për ta. Dhe mbi të gjitha, individë me potencial të jashtëzakonshëm, që shpesh mbeten të padukshëm.

Një realitet që nuk duhet të injorohet

Autizmi nuk është një sëmundje që duhet "shëruar". Është një mënyrë ndryshe e të menduarit, e të ndierit dhe e të përjetuarit të botës. Por pikërisht kjo "ndryshe" është ajo që shoqëria shpesh nuk arrin ta pranojë.

Në shumë raste, diagnoza e autizmit shoqërohet me heshtje, frikë dhe pasiguri. Familjet përballen me pyetje pa përgjigje: *A do të flasë? A do të jetë i pavarur? A do të pranohet?*

Këto nuk janë thjesht shqetësime personale, janë pasojë e një sistemi që ende nuk është i përgatitur të përqafojë diversitetin.

Nga ndërgjegjësimi te pranimi: Një rrugë e gjatë

Për vite me radhë, fushatat janë fokusuar në ndërgjegjësim. Por ndërgjegjësimi pa veprim është i pamjaftueshëm. Të dish për autizmin nuk mjafton duhet ta pranosh, ta respektosh dhe ta përfshish.

Histori që nuk tregohen mjaftueshëm

Në çdo komunitet ka histori të heshtura. Një fëmijë që shmang kontaktin me sy, por që ka një kujtesë të jashtëzakonshme. Një i ri që nuk flet shumë, por që krijon botë të tëra përmes artit apo teknologjisë. Një vajzë që përballlet me paragjykimet e dyfishta si person me spektrin autik dhe si grua.

Këto janë histori që rrallë bëhen tituj. Sepse shoqëria shpesh është më e fokusuar te "mungesat" sesa te aftësitë.

Por realiteti është ndryshe, shumë persona të këtij "spektri" kanë kontribuar në shkencë, art, teknologji dhe inovacion. Ata nuk kërkojnë mëshirë, kërkojnë mundësi.

Neurodiversiteti, një pasuri e pashfrytëzuar

Koncepti i neurodiversitetit ka filluar të ndryshojë mënyrën se si e kuptojmë autizmin. Ai na kujton se truri njerëzor nuk është uniform dhe pikërisht kjo shumëllojshmëri është burim forçe.

Individët autikë shpesh shquhen për vëmendje të lartë ndaj detajeve, mendim logjik dhe analitik, kreativitet unik, përkushtim dhe fokus të jashtëzakonshëm.

Në një botë që kërkon inovacion, këto cilësi janë të paçmueshme. Por ato mbeten të pashfrytëzuara nëse shoqëria nuk krijon hapësira për to.



Arsimi që përfshin, jo që përjashton

Një nga plagët më të mëdha mbetet sistemi arsimor. Shumë fëmijë autikë përjetojnë izolim në klasë, keqkuptime nga mësuesit dhe mungesë mbështetjeje profesionale.

Arsimi nuk duhet të jetë një betejë për mbijetesë, duhet të jetë një mundësi për zhvillim.

Kjo kërkon: mësues të trajnuar për nevoja të veçanta, ambiente të sigurta dhe mbështetje, bashkëpunim të ngushtë me prindërit.

Një sistem arsimor që nuk përfshin të gjithë, dështon në misionin e tij.

Punësimi

Për shumë të rritur me spektrin e autizmit, sfida më e madhe nuk është aftësia për të punuar por mundësia për t'u punësuar. Paragjykimet dhe mungesa e përshtatjeve në vendin e punës krijojnë barriera të panevojshme.

Megjithatë, kompanitë që kanë përqaftuar diversitetin tregojnë një realitet tjetër: produktivitet më të lartë, kreativitet më të madh dhe një kulturë më të shëndetshme.

